



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:203169

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05948415

C.nr.828/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Berkan Hamza dhe me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: Sh.Z nga fshati Dobidol, Komuna e Rahovecit, S.K nga fshati Rakovinë, Komuna e Gjakovës, T.Th nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, V.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, V.B nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, V1.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, Xh.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, Xh.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, Xh1.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit dhe Xh1.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson D.M, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 7,765.60 euro, jashtë seance me datë 17.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B, Xh.M, Xh1.B dhe Xh1.M.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses S.K nga fshati Rakovinë, Komuna e Gjakovës, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses T.Th nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë

21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.B nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V1.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit Xh.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit Xh.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e

paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IX. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Xh1.B nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.14 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 160.34 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 487.79 euro, në shumën e përgjithshme prej 651.27 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

X. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Xh1.M nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.36 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.24 euro, në shumën e përgjithshme prej 697.24 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 21.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses S.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetore, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses T.Th, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XIII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit V.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XIV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit V.B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit V1.B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XVI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit Xh.B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XVII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit Xh.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XVIII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses Xh1.B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 651.27 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 125.29 euro.

XIX. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses Xh1.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Gusht 2020, për periudhën kohore 22 Nëntor - Dhjetor 2022 dhe shuma e kërkuar në emër të kamatë vonesës vjetor, përtej shumës së aprovuar prej 697.24 euro e deri në shumën 776.56 euro, dhe atë në shumën prej 79.32 euro.

XX. HEDHET POSHTË si e palejueshme e padia e paditëses Sh.Z, me të cilën ka kërkuar kompensim në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

XXI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B, Xh.M, Xh1.B dhe Xh1.M, ti paguaj shumën prej 333.00 (treqind e pesëdhjetë e tre euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit Sh.Z, S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B, Xh.M, Xh1.B dhe Xh1.M në këtë gjykatë me datë 21.09.2023, përmes të autorizuarit të tyre D.M, avokat në Prizren, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e

përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që paditësve në emër të kompensimit të shtesë mbi bazën e përqindjes të inflacionit të iu paguaj dhe atë: 1.për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, 2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, 3.për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2022 në shumën prej 537.19 euro dhe 4. në emër të kamat vonesës vjetore në shumën prej 57.51euro, në shumën e përgjithshme prej 776.56 euro. Gjykatës i kanë propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 21.09.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore nga viti 2020 –2022, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërësi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shume se 3 vite. Duke shtuar se padia e paditësve nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjellimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara me padi, paditësit nuk kanë arritur ta argumentoj themelësinë e kërkesëpadisë ndaj të paditurës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Rudolf Walther” në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve Sh.Z dhe Xh1.B

është shuma prej 393.00 euro, lartësia e pagës bazë e paditësit Xh.M është shuma prej 494.00 euro, ndërsa lartësia e pagës bazë e paditësve S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B dhe Xh1.M është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë

e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B, Xh.M dhe Xh1.M, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II. III. IV. V. VI. VII. VIII. dhe XI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.36 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 4 = 2.52$)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 = 171.76$)

Për periudhën Janar 2022 - 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54euro [$421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.36$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.18 sipas ($48.83 / 30 = 1.6276 * 21 \text{ ditë} = 34.18$) = $488.36 + 34.18 = 522.54$).

Ndërsa paditëses Xh1.B i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën dhe IX. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 393.00 euro, i bie

që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.14 euro ($393 \cdot 0.2\% = 0.78 \cdot 4 = 3.14$)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.34 euro ($393 \cdot 3.4\% = 13.36 \cdot 12 = 160.34$)

Për periudhën Janar 2022 - 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 487.79 euro [$393 \cdot 11.6\% = 45.58 \cdot 10 = 455.80$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 31.91 sipas ($45.58/30 = 1.51 \cdot 21 \text{ ditë} = 31.91$) = $455.88 + 31.91 = 487.79$].

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, ka vendosur si në pikën II. III. IV. V. VI. VII. VIII. IX. X. dhe XI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë të paditësve si në dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për paditësit S.K, T.Th, V.M, V.B, V1.B, Xh.B, Xh.M dhe Xh1.M për secilin veç e veç, në shumën prej 79.32 euro, si dhe për paditësen Xh1.B, në shumën prej 125.29.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 01.01.2020 deri më datë 31.08.2020. Baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 21.09.2023, ndërsa sa i përket paditëses Xh1.Be njëjta ka përfituar ngritje në bazë të pagës bazë (393.00 euro) dhe jo siç pretendon paditësja në bazë të pagës bazë (421.00euro). Po ashtu sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, realizimi i të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021, duhet të trajtohen deri më datën 21.11.2022, kur edhe është shkëputur kjo kontratë nga njëra kontaktuese. Andaj, kërkesës që përfshin periudhën kohore prej datës 22.11.2022 deri më datë 31.12.2022, si dhe kamata vonesa vjetore e kërkuar në shume prej 57.51 euro janë refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditësi Xh.M kishte pagën bazë në shumë prej 494.00 euro. Në Ligjin për Procedurën Kontestimore neni 2 par. 1 përcaktohet *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*. Pasi që në rastin konkret paditësi Xh.M sipas kërkesëpadisë ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit në bazë të pagës bazë në shumën prej 421.00. euro dhe në shumën si në pikën VIII. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe duke marr parasysh faktin e

njëjta shumë është brenda kufijve të kërkesës, gjykata ka vendosur që të njëjtin ta kompensoj si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Kjo gjykatë ka vërtetuar faktin se me aktgjykimin C.nr.424/2022 (2022:132851), të datës 13.05.2024, paditësja Sh.Z është kompensuar në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore Korrik - Dhjetor, në shumën prej 63.66 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 9.43 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 160.34 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 455.88 euro. Andaj, sipas aktgjykimit të lartcekur vërtetohet fakti se paditësja Sh.Z është kompensuar për periudhën kohore e cila është edhe objekt i këtij kontesti.

Kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditëses Sh.Z, e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (date e prashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën XXI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 333.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.828/2023, më datën 17.07.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.